



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.2.2025

Nr: 176

Ora:14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT”, ME KRYETAR Z. ARIAN STAROVA, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot më datë 25.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1243 datë 24.02.2025, me:

- Kërkues:** Partia politike “Bashkimi Liberal Demokrat”, me kryetar Z. Arian Starova
- Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Bashkimi Liberal Demokrat” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025
- Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Partia “Bashkimi Liberal Demokrat”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Arian Starova, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 21.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se partia “Bashkimi Liberal Demokrat”, me initiale “BLD”, me Kryetar Z. Arian Starova, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);

Data:25.2.2025 Nr: 176
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Bashkimi Liberal Demokrat”, me Kryetar Z. Arian Starova, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”

- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Bashkimi Liberal Demokrat”, me shkronja nistore “BLD”, me adresë: Rruga e Elbasanit, Nr. 17, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Arian Starova, me adresë: Rruga "Sulejman Pasha", Pll. 92/1, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Kimete Rama, me adresë: Rruga "Nuri Kello", Nj. nr. 9, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Shaqir Rexhvelaj, me adresë: Rruga "Myslym Shyri", Pll. 44/2, H. 8, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia “Bashkimi Liberal Demokrat”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga partia “Bashkimi Liberal Demokrat”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025”.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Bashkimi Liberal Demokrat”, me kryetar Z. Arian Starova, me shkronjat nistore “BLD”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI